

## Përkrahja e mësimit në distancë nga shtëpia

Për të gjithë fëmijët tani është kohë e veçantë e mësimit. Fëmijët dhe të rinjtë tani mësojnë kryesisht në shtëpi, me mësimit në distancë.

Mësim në klasë organizohet në shkollë për nxënësit e klasëve 1.-3. dhe për nxënësit e parashkollores. Poashtu, nxënësve që kanë vendimin për ndihmë të veçantë si dhe atyre me obligim të zgjatur të shkollimit fillor, do të organizohet mësim në klasë nëse ka nevojë. Gjithashtu edhe nxënësit e mësimit përgaditor për shkollë fillore mund të mësojnë në klasë filluar nga data 14.4.2020. Sidoqoftë, nëse prindërit kërkojnë, të gjithë këta nxënës kanë të drejtë të marrin mësim në distancë. **Mësimi në distancë në shtëpi është alternativa primare që i preferohet të gjithë nxënësve.**

Detyrat shkollore dhe mësimi në shtëpi mund të jenë me sfida. Shkollat po punojnë mjaftë që këtë mësim në distancë ta bëjnë sa më të rrjedhshëm. Situata është e re për të gjithë ne, andaj duhet të besojmë se secili po bën çmos duke e dhënë maksimumin. Së shpejti fëmijët do të kthehen prap në shkollë.

Është me rëndësi të gjindet rutina e mësimit dhe e bërjes së detyrave shkollore në ambientin dhe kushtet shtëpiake. Këtu janë disa këshilla që mbështesin mësimin në distancë të fëmijës në shtëpi.

- ✓ Shkolla edhe më tutje përgjigjet për mësimin. Nuk kanë mundësi të gjithë prindërit ta mbështesin/ndihmojnë fëmijën në mësim, për shembull për shkak të dënimit të pamjaftueshme të finlandishtes/suedishtes. Mësueset janë në dispozicion për pyetje dhe ndihmë.
- ✓ Nëse fëmija i juaj nuk ka kompjuter në përdorim, kontaktin mund ta mbanë edhe me telefon mobil. Nëse në shtëpi nuk ka aparat të përshtatshëm atëherë kontaktoni shkollën për këtë.
- ✓ Së bashku me fëmijën shiqoni udhëzimet që vijnë nga shkolla. Ndihmoni fëmijën që ti përcjellë udhëzimet dhe të mbanë kontaktin me mësueset.
- ✓ Kujdesu që fëmija i juaj ti ketë mjetet e punës të cilat zakonisht i përdorë gjatë mësimit.
- ✓ Së bashku me fëmijën bisedoni dhe planifikoni orarin e mësimit. Shkruani orarin në letër dhe përdorni edhe foto si ndihmë. Orarin vendosni në një vend qendror që të shifet mirë.
- ✓ Së bashku me fëmijën gjeni në shtëpi një vend ku fëmija të mund të koncentrohet në detyrat shkollore dhe ku i ka materialet e duhura. Kjo i krijon siguri dhe qetësi pune.
- ✓ Mendoni se sa gjatë mund të punon fëmija. Koha e rezervuar për mësim në shtëpi mund të jetë më e shkurtër se sa ora e mësimit në shkollë.
- ✓ Fëmiju ndoshta ndihet i vetmuar pranë detyrave shkollore. Andaj është mirë ta inkurajoni që detyrat ti bën së bashku me shokët/shoqet me kontakt në distancë apo me motrën apo vëllaun në shtëpi. Është më knaqësi kur punohet së bashku!
- ✓ Rezervoni kohë edhe për të dalur jashtë. Lëvizja dhe fiskultura si dhe loja janë pjesë e rëndësishme e mësimit në distancë.

- ✓ Bëni rregullat e qarta për kohën që do ta kalon pranë ekranit jashtë kohës së mësimet.
- ✓ I jepni mundësi që fëmija ti shprehë emocionet dhe përcaktoni saktë synimet. Nëse fëmija për shembull nuk ka më energji për detyrën e fundit të asaj dite, atë mund ta bën më vonë. Mësueset ndihmojnë fëmijën që më vonë ta zen hapin me mësimet që në këtë situatë mbesin pa u mësuar.
- ✓ Të gjithë tjerët që gjinden në shtëpi duhet ta respektojnë kohën e rezervuar të fëmijës për detyra dhe mësim. Familja mbanë përgjegjësinë e përbashkët për krijimin e qetësisë fëmijës për të menduar dhe për të punuar.
- ✓ Nëse brengoseni lidhur me mësimin ose mirëqenien e fëmijës së juaj, kontaktoni me shkollën. Nëse brengosja e juaj në rradhë të parë e përket mësimin, kontaktoni me mësuesen. Nëse brengoseni për mirëqenien e fëmijës, kontaktoni me psikologun e shkollës ose me punëtoren sociale të shkollës.

Në këtë tekst janë shfytëzuar tekstet e asistentes pedagogjike Fredrika Nyqvist të Lärumi, të Förbundet Hem och Skolan dhe të Shoqatës së prindërve të Finlandës.